Projekti BLUE_BOOST synon të rrisë potencialin e risive të sektorëve tradicionalë dhe atyre emergjentë të ekonomisë blu me tendencë rritjeje të shpejtë në zonën Adriatiko-Joniane që përkufizohen si sektorët Blue Growth. Partnerët nga 7 shtete janë duke u fokusuar në bashkëpunimin ndërshtetëror dhe ndër-sektorial të grupimeve detare përmes shkëmbimit të njohurive bazuar në konceptet e tematikave të përbashkëta.

Data e fillimit
01 01 2018

7 Partnerët

4 Vendet

Buxheti
1.5 M €

5 Partnerët
e Associuar

Kohëzgjatja
22 muajt

Partneri Lider

Dhoma Kroate e Ekonomisë
Dhoma e Qarkut të Zadarit

Partnerët e projektit

Universiteti i Kamerinos

Dhoma e Tregëtisë
dhe Industrisë e Selanikut

Iniciativa Qendrore Evropiane

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Parku Shkencor i Patras

Rajoni i Puglias

www.interregadrion.eu

Kontaktet e partnerit
Dhoma Kroate e Ekonomisë
Dhoma e Qarkut të Zadarit
Maša Jurin mjurin@hgk.hr

Kontaktet e komunikimit
Iniciativa Qendrore Evropiane
Sekretariati Ekzekutiv
euprojects@cei.int

PARTNERËT E ASSOCIUAR
Ministria e Ekonomisë e Malit të Zi
Industria Detare Kroate
Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
OGS - Instituti Kombëtar i Oqeanografisë
dhe Gjeofizikës së Aplikuar (Itali)
Agjensia e Zhvillimit e Selanikut (Greqi)

Interreg
ADRION
ADRIATIC-IONIAN
EUROPEAN UNION
European Regional Development Fund - Instrument for Pre-Accession II Fund

BLUE_BOOST

NXITJA E POTENCIALIT TË RISIVE NË SEKTORËT BLUE GROWTH NE ZONËN ADRIATIKO JONIANE (ADRION)

RRETH BLUE_BOOST

Grupimet detare brenda zonës Adriatiko-Joniane (ADRION), karakterizohen nga aktivitete të larmishme, boshllëk në ndërveprimin mes katër helikave respektive (qeveri,industri, trajnim dhe shoqëri) dhe një ambient me mungesë ndërveprimi sidomos në nivel ndërsektorial.

BLUE_BOOST ka si qëllim çlirimin dhe fuqizimin e potencialeve të njohurive dhe transferimit të teknologjive, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërsektorial të aktorëve kyç në sektorët e Blue Growth duke fuqizuar marrëdhëniet dhe ndërveprimin brenda dhe mes grupimeve të ngjashme, bazuar në një sistem shkëmbimi njohurish të hapur dhe të mbështetur në komunitet.

Bashkëpunimi me "agjentë të risive" si p.sh. individë, qëndra eksperimentimi të hapura ose të mbyllura, laboratorë, hapësira të përbashkëta, etj. është me rëndësi kyçe për afrimin dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet katër helikave të grupimeve detare të përfshira.
Qëllimi është të analizohen ndërthurje të mundshme ndërmjet sektorëve, ide dhe kompetenca të reja, aleanca dhe rrjete të reja midis individeve ose komuniteteve, ndërrmarjeve, organizatave dhe instucioneve të ekonomisë detare

OBJEKTIVAT

- Të rrisë shkallën e novacioneve në sektorët e Blue Growth, të zonës ADRION;
- Të nxisë dhe udhëheqë kapacitetet novative të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME-ve) dhe Start Up - eve në sektorët tradicionalë të Blue Growth (peshkimi, ndërtimi i anijeve, etj) dhe sektorëve që po lindin si (teknologjitë blu që përfshijnë akuakulturën, ndërtimin e anijeve green, robotikën, materialet e reja etj);
- Të ofrojë njohuri për novacionet në sektorët Blue Growth , MSME-të dhe Start Up-et
- Të ofrojë deri në 350 000 Euro, në kupona, për kompanitë e përzgjedhura për të realizuar novacionet.
- Të promovojë ekspertizën e ekspertëve të sektorëve në ekonominë blu dhe agjentëve të tjerë në kontekstin ndërshtetëror.
- Të promovojë Strategjinë e Rrjetëzimit Ndërshtetëror të Inovacionit dhe Planin e veprimeve të përbashkëta për të përmirësuar bashkëpunimin ndërshtetëror të MSME-ve të përfshira në Blue Growth.



AKTIVITETET

LABORATORË BLU, SEMINARE , HACKATHONË

Projekti BLUE_BOOST do të organizojë laboratorët blu, seminaret dhe hackathon-et si instrumenta formimi profesional dhe kualifikimi, në të cilat ndërmarjet do të zhvillojnë projektet e tyre të novacioneve nën drejtimin e ekspertëve të Blue Growth dhe/ose të "novacioneve".

SKEMAT "VOUCHER" PER NOVACIONET

Janë planifikuar të ofrohen deri në 350 000 Euro, për të paktën 35 projekte në shkallë të vogël, të cilat do të financohen nëpërmjet skemës së kuponëve (Voucher), për përditësimin e projekteve të novacioneve të përgatitura nga MSME-të.

DATABAZË E OFRUESVE TË NJOHURIVE

Projekti do të krijojë një bazë ndërshtetërore të dhënash për ofruesit e njohurive, ose e thënë ndryshe për ekspertët e Blue Growth dhe "agjentët e rinj të novacionit".

KAPITALIZIMI NË TERMA AFATGJATË

Do të aprovohet një strategji ndërshtetërore e rrjetit për novacionin si dhe një plan i përbashkët veprimi për kapitalizimin e rezultateve të projektit, për grupimet detare, jo vetëm në 7 vendet e zonës Adriatiko-Joniane por edhe më tej.